



## UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 01/2010

### Mbi caktimin e shpenzimeve të reprezentacionit për anëtarët e KQZ-së

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

Në bazë të autoritetit të dhënë me Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe Udhëzimin Administrativ të Zyrës së Kryeministrit nr. 01/2008 “Për caktimin e shpenzimeve të reprezentacionit për zyrtarët e institucioneve të Republikës së Kosovës”,

nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

#### Neni 1

##### Qëllimi

1.1 Ky Udhëzim Administrativ u siguron anëtarëve të KQZ-së, Kryeshefit Ekzekutiv dhe Drejtorëve të Departamenteve të Sekretariatit të KQZ-së (në tekstin e mëtejme: Shfrytëzuesit) procedurat për caktimin dhe përdorimin/shfrytëzimin e mjeteve të reprezentacionit për aktivitetet e tyre zyrtare dhe operative në kuadër të përgjegjësive të tyre.

1.2 Ky Udhëzim Administrativ synon caktimin e lartësisë së shpenzimeve të reprezentacionit për shfrytëzuesit, përdorimin dhe shfrytëzimin ekonomik dhe efikas të tyre.

1.3 Për qëllime të këtij Udhëzimi “Shpenzime të reprezentacionit” do të thotë të gjitha shpenzimet që bëhen me rastin e kryerjes së punëve dhe detyrave siç janë drekat apo darkat me delegacione të ndryshme, pijet gjatë takimeve të ndryshme, si dhe dhuratat e rastit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 2

##### Caktimi i lartësisë së shpenzimeve

- a) 2.1 Shfrytëzuesve të reprezentacionit si në pikën 1.1 të këtij Udhëzimi u caktohet vlera e shpenzimeve të reprezentacionit si në vijim:
- a) Kryetarit të KQZ-së deri në 150 (njëqindpesëdhjetë ) Euro në muaj;
  - b) Anëtarëve të KQZ-së deri në 80 (tetëdhjetë) Euro në muaj;
  - c) Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së deri në 100 (njëqind) Euro në muaj;
  - d) ZV i Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së deri në 40 (dyzetë )Euro në muaj;
  - e) Drejtorëve të Departamenteve të SKQZ-së deri në 40 (dyzetë) Euro në muaj

#### Neni 3

##### Përdorimi i shpenzimeve të reprezentacionit

- 3.1 Shpenzimet e reprezentacionit përdoren vetëm për mbulimin e shpenzimeve të takimeve zyrtare dhe nuk mund të përdoren për qëllime të tjera.
- 3.2 Të gjitha shpenzimet e reprezentacionit duhet të arsyetohen me fatura përkatëse dhe të nënshkruara nga shpenzuesi.
- 3.3 Të gjitha shpenzimet e reprezentacionit që kalojnë shumën e përcaktuar me këtë Udhëzim do të mbulohen nga shfrytëzuesi, i cili e ka tejkaluar shumën e përcaktuar.
- 3.4 Në raste të veçanta lartësinë e shpenzimeve të reprezentacionit e cakton Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me autorizim të veçantë.
- 3.5 Shpenzimet e reprezentacionit duhet të miratohen në buxhetin e vitit fiskal të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

#### Neni 4

##### Akumulimi i shpenzimeve të reprezentacionit

Shpenzimet e reprezentacionit nuk mund të akumulohen dhe vlera e shpenzimeve mbyllet në ditën e fundit të muajit.

#### Neni 5

##### Ndryshimet dhe plotësimet

KQZ-ja, ndryshimet dhe plotësimet e këtij Udhëzimi mund t'i bëjë sipas procedurës së miratimit.

#### Neni 6

##### Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ i KQZ-së hyn në fuqi datën me 28/09/2010.

Valdete Daka

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve